

Në bazë të nenit 29. paragrafi 2. Të Ligjit mbi pronësi shtetërore („Fletore zyrtare e Malit të Zi“, br.21/09 i 40/11) në lidhje me nenin 194 , 201 , 208 dhe 216 të Ligjit për marrëdhënie juridiko pronësore („Fl.zyrtare“,19/09), 9. e nenit 33. pika 6., 1.pika 1. dhe nenit 38.paragrafi 1.pika 2. të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale („Fletore zyrtare e Malit të Zi“, nr-2/18, 34/19,38/20,50/22 dhe 84/22)dhe të nenit 32.paragrafi 1.pika 6 , dhe të nenit 58. Paragrafi 1. Pika 9.e Statutit të Komunës së Ulqinit („Fletore zyrtare e Malit te Zi- Rregullorja e komunës nr.48/19), Kuvendit të Komunës së Ulqinit , në mbledhjen e mbajtur më 21.12.2022. morri

VENDIM

Për dhënien e pëlqimit për konstatimin e të drejtës së kalimit për vendosjen e dy llinjave kabllore 10 Kv nga TS 10/0,4 Kv 2x1000 Kva „Pinjesh 2“ deri ne TS 10/0,4 Kv 1x630 Kva „Pinjesh 4“KK Ulqin

Neni 1.

Jepet pëlqim për konstatimin e të drejtës së kalimit me pagesë në

-parcelen kadastrale nr.3461/1 me sipërfaqe prej 1 m2 nga fleta poseduese numër 607 ,në pronësi të Malit të Zi , e drejta e disponimit Komuna e Ulqinit , me kulturë pyll i klasit të 1 , ku do të vendoset kabllloja me gjatësi prej 1,32 m ,

-parcelen kadastrale numër 7246/6 me sipërfaqe prej 7 m2 , pyll i klasit të 4 nga fleta poseduese 607 , në pronësi të Malit te Zi , e drejta e disponimit Komuna e Ulqinit , ku do të vendoset kabllloja me gjatësi prej 10.66 m.

Neni 2.

E drejta nga neni 1 i këtij Vendimi jepet me qëllim të vendosjes së dy kablllove nëntokesore prej 10 Kv TS10/0,4 Kv x 1000 Kva „Pinjesh 2“ deri në TS 0/0,4 Kv 1x630 Kva „Pinjesh 4“ KK Ulqin.

Neni 3.

Në patundshmeritë nga neni 1 i këtij Vendimi lejohet e drejta e kalimit me pagesë në vlerën prej 122 eura m2 X 15% të vlerës së tregut për 1m2 , që gjithsej kushton **146,40euro**.

Shuma e lartpërmendur është caktuar nga vlerësuesi i autorizuar i administratës shtetërore , Komisioni i Administratës pronësore të Malit të Zi është formuar me Vendimin 01-012/21-26369 të datës 18.11.2021. dhe 01-012/21-12423/1 od 17.06.2022.

Neni 4.

CEDIS(Rrjeti i shpërndarjes së energjisë elektrike), SHPK Podgoricë ,rruga Ivan Millutinoviç nr.12, PIB 03099873, obligohet që pas përfundimit të punimeve në vendosjen e kablllove për të cilat është marrë e drejta e kalimit , patundshmëria të kthehet në gjendje fillestare.

Neni 5.

Autorizohet Kryetari i Komunës së Ulqinit që me shfrytëzuesin të nënshkruajë kontratë për shfrytëzimin e të drejtës së kalimit për patundshmërite nga neni 1. I këtij vendimi.

Neni 6.

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e publikimit në Fletoren zyrtare të Malit të Zi – rregulloret komunale.

KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT

Numër: 02-016/22-553-4
Ulqin, më 21.12.2022

KRYETAR
Ardijan Mavriq